



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER**

*Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22*

**Nr. Rregj.Them.303/1196**  
**Dt. Rregj. 17.04.2015**

**Nr. Vendimi 9**  
**Dt. Vendimi 11.01.2016**

**V E N D I M**

**"NE EMER TE REPUBLIKES"**

Gjykata Administrative e Shkalles se pare Shkoder e perbere nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

asistuar nga sekretare gjyqesore **Borana LITI**, sot me date 11.01.2016 ora 11.30 mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore çeshtjen administrative me nr. Rregj. 1196 datë 17.04.2015 që l përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Naim Bashi, i biri i, i dtl. 13.11.1959, me nr identifikues, F91113072L lindur e banues ne L. Qafe Hardhi, Rruga Kupe Danja, Pallati 86,Shkoder Nr cel. 0696879266. Cel. 0674049601( në mungesë).

**E PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder ( në mungesë).  
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranw ( në mungesë).

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e Akt Kontrollit me nr. Prot. 323/8, te dates 11.12.2014, te Drejtorise se Tatimeve Shkoder, te njoftuar me Njoftim Vleresimet me nr 323/9, te dt. 11.12.2014.  
Detyrimin e te paditurit te heqe nga sistemi tatimor te gjitha gjobat dhe detyrimet qe rezultojne sipas aktit administrativ te pershkruar me siper.

**BAZA LIGJORE:** Neni 15/a, 17/1/a, 18 e 21 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin e funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative" Neni 154 e 156 te K.Pr.Civile.Neni 37, 67 dhe 114 i Ligjit 9920, dt. 19.05.2008, "Per Procedurat Tatimore" I Ndryshuar.

Gjykata në mungesë të palëve ndërgjyqëse, pasi konstatoi se nga ana e palës paditëse është depozituar kërkesë me shkrim për pushimin e gjykimit të çështjes,

## VEREN:

Naim Bashi është i ardhur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkoder, me objekt:

Shfuqizimin e Akt Kontrollit me nr. Prot. 323/8, te dates 11.12.2014, te Drejtorise se Tatimeve te Rajonit te Shkoder me Njoftim Vleresimet me nr 323/9, te dt. 11.12.2014. Detyrimin e te paditurit te heqe nga sistemi tatimor te gjitha gjobat dhe detyrimet qe rezultojne sipas aktit administrativ te pershkruar me siper.

Ne seancen e dates 11.01.2016, Gjykata konstaton se nga ana e palës paditëse është depozituar pranë kësaj gjykate me datë 08.01.2015, kërkesë për pushimin e gjykimit të çështjes pasi do të drejtohet me një tjetër objekt gjykimi.

Ne nenin 39 pika 3 të ligjit 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", parashikohet se gjykata vendos pushimin e gjykimit kur paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë.

Gjithashtu ne nenin 201, paragrafi i pare i K.Pr.Civile, parashikohet se:

"Paditesi ne çdo faze te gjykimit mund te heqe dore nga gjykimi i padise". Ne kete rast gjykata vendos pushimin e gjykimit."Edhe ne nenin 299, germa "b" te K.Pr.Civile, eshte parashikuar si nje nga rastet e pushimit te gjykimit kur paditesi heq dore nga gjykimi i çështjes.

Nisur nga sa sanksionohet ne keto nene dhe nga sa rezultoi ne gjykim, duke qene se paditësi kërkoi pushimin e gjykimit, gjykata çmon se çështja duhet pushuar.

## PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 39/3 të Ligjit 49/2012

## VENDOSI

Pushimin e gjykimit të çështjes me nr. rregj, them 303/1196 date 17.04.2015 ,të ngritur nga pala paditëse Naim Bashi.


Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim i vecantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.


Për palët (në mungesë), ky afat fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

**Shkoder me date 11.01.2016**

**SEKRETARE SEANCE**  
**Borana LITI**



**GJYQTARE**  
**Valbona DURRAJ**



**VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË**

**PULLE TARIFE SOT ME DATË 02.03.2016**



**KANCELARE**  
**BLERTA NURJA**

